

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Konkursi ndërkombëtar/ Plani për Porto Palermon, nga Muzeu i Luftës së Ftohtë tek ish-kazermat (hotel) për vizitorë
ADRESA	https://tpz.al/konkursi-nderkombetar-plani-per-porto-palermom-nga-muzeu-i-luftes-se-ftoh-te-tek-ish-kazermat-hotel-per-vizitore-i332942
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 07:13:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 07:02:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4c241919c70f36fc63fd45d92cc8ddcd144682ead82a72df311396d4c5b57312
TEKSTI	815aeb40b86a42187ace5cbdd077947d84cc307f3be6a7aa186ddd322162534d
PAMJA	2f3e9a2ad523955d2b30caee71d17839fb183be6e5b284b998dbe2ba46d7e6fa

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	81bd9c0420a1881aa45976535f313db274176d842f17e69896e43ff2928cac22
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	144dcc84d15b7d80530ccf1620af6bb24eccd27028b717aa2669aa241970dde3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/81bd9c0420a1881aa45976535f313db274176d842f17e69896e43ff2928cac22>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

09:09 Detaje të reja/ I dënuar përjetë për krime të rënda, mister mbi 16 lejet e burgut ndaj Alket Rizait në Greqi!

09:02 Konkursi ndërkombëtar/ Plani për Porto Palermon, n

AKTUALITET, 15 SEPTEMBER 2026, 09:02

Konkursi ndërkombëtar/ Plani për Porto Palermon, nga Muzeu i Luftës së Ftohtë tek ish-kazermat (hotel) për vizitorë

tpz.al TPZ



Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) ka hapur një konkurs ndërkombëtar për transformimin e ish-bazës ushtarake dhe Tunelit të Nëndetëseve në Porto Palermo në një kompleks të ri publik kushtuar kujtesës së Luftës së Ftohtë, kulturës dhe vizitës.

Projekti parashikon që tuneli i nëndetëseve të bëhet Muzeu i Luftës së Ftohtë, ndërsa ish-kazermat ushtarake të ripërdoren për akomodim, gastronomi, aktivitete kulturore dhe edukative.

"Dikur i ndërtuar për të mbetur i fshehur. Nesër, një mundësi për të hyrë, kuptuar dhe kujtuar", thuhet në thirrjen e publikuar nga AKPT, e cila fton arkitektë dhe ekupe multidisiplinare nga Shqipëria dhe jashtë vendit të paraqesin koncept-ide të tyre.

Konkursi organizohet nga AKPT në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake. Sipas dokumentacionit të konkursit, AKPT është ngarkuar si organi qendror blerës për zhvillimin e procedurës.

Në qendër të ndërhyrjes është Tuneli i Nëndetëseve. Dokumenti e përshkruan atë jo thjesht si hapësirën ku do të vendoset muzeu, por si vetë objektin kryesor të tij. "Tuneli nuk është thjesht një hapësirë në të cilën duhet vendosur një muze. Vetë tuneli është artefakti kryesor i muzeut", thuhet në termat e referencës.

Tuneli ka një gjatësi të raportuar prej rreth 655 metrash, lartësi rreth 11 metra dhe gjerësi minimale rreth 11 metra. Pjesa ujore varion nga rreth 7 deri në 14 metra në gjerësi, ndërsa thellësia është kryesisht 6-8 metra dhe në zona të caktuara arrin rreth 11 metra.

Kompleksi nëntokësor nisi të ndërtohej në 1969, gjatë bashkëpunimit të atëhershëm mes

ide!

Në Shqipërinë e sotme "revolucionin" ka emrin pjesëmarrje dhe alternativë

Nga Preç Zogaj

John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandit?

Nga Thoma Gëllçi


Tej e Këtej



Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori? Ola Xama tragon nga i duhet super

Shqipëria dhe Kina, dhe punimet vijuan për ardoq dekada. Ai u projektua nënshtrirë për mjete detare dhe më pas u përshtat për përdorimin nga flota shqiptare e nëndetëseve, përfshirë nëndetëset e Projektit 613, të njohura nga NATO si klasa "Whiskey".

Tuneli ishte projektuar sipas standardeve të kohës për mbrojtjen antibërthamore. Dy portat e tij të blinduara dhe hermetike ishin ndërtuar për t'u rezistuar sulmeve ajrore dhe shpërthimeve deri në 10 kiloton. Hyrja jugore është sot e hapur, ndërsa porta veriore mbetet e mbyllur.

Ish-kazemat, nga baza ushtarake në qëndrim për vizitorët

Konkursi shkon përtej muzeut në brendësi të tunelit. Ish-kazemat, shumica e të cilave janë aktualisht të degraduara, do të marrin funksione të reja. Dokumenti parashikon që akomodimi të jetë i lidhur drejtpërdrejt me identitetin e ish-bazës, muzeun dhe peizazhin.

Në ish-kazema mund të zhvillohen gjithashtu funksione pritjeje, gastronomi, edukim, kulturë dhe shërbime të tjera të nevojshme për kompleksin.

Termat e referencës përcaktojnë se vizitorët mund të qëndrojnë në Porto Palermo për një natë ose për periudha më të gjata, të lidhura me programe kulturore, edukative apo kërkimore. Por dokumenti vendos një kufi të qartë ndaj zhvillimit tradicional turistik.

"Qëllimi nuk është krijimi i një destinacioni konvencional turistik bregdetar", por një formë mikpritjeje e lidhur me historinë, kulturën, peizazhin dhe karakterin e Porto Palermos.

Po kështu, projekti nuk duhet të synojë maksimizimin e shtretërve. Termat kërkojnë që kapaciteti i akomodimit të përcaktohet nga potenciali i ndërtesave ekzistuese, cilësia e qëndrimit dhe kapaciteti real i territorit.

Synimi është që muzeu, aktivitetet kulturore dhe qëndrimi në ish-bazë të krijojnë arsye për ta vizituar Porto Palermon edhe jashtë sezonit veror. Dokumenti kërkon gjithashtu lidhje me ekonominë vendase përmes punësimit, sipërmarrjeve të vogla, gastronomisë lokale, artizanatit, guidave dhe shërbimeve të tjera.

Një pjesë e Porto Palermos mbetet bazë ushtarake

Transformimi nuk do të përfshijë të gjithë ish-kompleksin. Një pjesë e Porto Palermos vazhdon të përdoret nga Forcat Detare Shqiptare për funksione operacionale dhe stërvitore.

Moli i vogël dhe godina pranë tij do të mbeten në përdorim ushtarak, ndërsa helipadi do të vazhdojë të ruajë funksionin operacional të Forcave Detare. Jashtë periudhave kur nevojitet për operacione ose stërvitje, helipadi mund të përdoret edhe nga kompleksi i ri, sipas kushteve të sigurisë.

Konkursi zhvillohet gjithashtu brenda një territori të mbrojtur. Parku Natyror i Gjirit të Porto Palermos ka një sipërfaqe prej rreth 1,695 hektarësh, gati 88% e së cilës është detare. Zona me regjim strikt mbrojtjeje që mbivendoset me territorin e konkursit përcaktohet si zonë pa ndërhyrje fizike.

Edhe Kalaja e Porto Palermos mbetet jashtë ndërhyrjes. Sipas kushteve të konkursit, ajo nuk është objekt projektimi dhe duhet të trajtohet si pjesë e eksperiencës së përgjithshme të vizitorit dhe e marrëdhënies mes muzeut, gjirit dhe peizazhit./ Monitor

Regjion për t'u vizituar
imuniteti Gent Sejkos

[Shiko të tjera video](#)

[fiskale për naftën, akti Normativ i akcizës nuk është më në fuqi](#)

[Nderit të Shqipërisë, kryeministri Rama shkon në Napoli](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 20:03

[Nis protesta e 107-të para Kryeministritë, protestuesit thirrje kundër klasës politike](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 19:47

[Rama për pagat e gjyqtarëve: Askush nuk e zëvendëson Parlamentin dhe nuk mund ta urdhërojë legjislativin](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 19:40

[Klube, mentorim dhe ndihmë me detyrat, ja si do të funksionojë programi 'Pas shkolle' në 408 institucione arsimore](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 19:28

[Partia Mundësia mbledh strukturat për zgjedhjet lokale 2027/ Shehaj: Do të jemi në çdo Këshill Bashkiak](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 18:49

[Divjaka nuk tërhiqet, kundërshton bashkimin me Lushnjën. Relacioni gati për Kuvendin](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 18:43

[20 sulme kibernetike gjatë këtij viti/ Kazia: Tentative për dezinformim nga vende të huaja](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 18:26

[Diaspora4Innovation: Nga](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 18:17

[Alarmi për bombë në shkollën](#)

[ekspertiza e diasporës te partneritetet afatgjata](#)
Artikull Promocional

["Edith Durham", Koçiu: Një çmenduri e mirëfilltë kriminale](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 18:11

[Butrinti shënon rekord vizitorësh, të ardhurat rriten me 218% krahasuar me 2023](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 17:35

[Kërcënimi me jetë i gazetarit Osman Stafa, reagon Policia](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 17:02

[Pajisje wireless dhe alkool! Kontroll blic me urdhër të SPAK-ut në paraburgimin e Bradasheshit](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 16:53

[Miratohet në parim rritja e pagave për gjyqtarët/ Komisioni i Ekonomisë kalon draftin e propozuar nga PS](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 16:22

[Fluturimet gjatë verës: Shqipëria mes vendeve me rritje të lartë të trafikut ajror](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 16:10

[Kërcënohet me vdekje gazetari Osman Stafa, SafeJournalists: Autoritetet shqiptare të nisin hetimet urgjentisht](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 16:00

[VIDEO/ Gjergj Luca ironizon Berishën nga Fieri: Sot edhe](#)

AKTUALITET / 14 September 2026, 15:40

[Më pak investime jashtë/ BSH: Rreth 80 milionë euro u](#)

une jam demokrat, ne krah te
Gaz Bardhit

kanalizuan drejt bizneseve
dhe kompanive të huaja

AKTUALITET / 14 September 2026, 15:33

Vendimi i Anelit në Ilir

AKTUALITET / 14 September 2026, 15:16

Dagat e magistratëve Blushi

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.